



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 05/L -056**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES BILATERALE NDËRMJET  
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË SË  
DUKATËS SË MADHE TË LUKSEMBURGUT PËR PROJEKTIN E  
BASHKËPUNIMIT PËR ZHVILLIM: “KSV/018: MBËSHTETJE  
INSTITUCIONALE DHE TEKNIKE PËR SISTEMIN E FURNIZIMIT  
ME UJË NË RAJONIN E MITROVICËS”**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES BILATERALE  
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE  
QEVERISË SË DUKATËS SË MADHE TË LUKSEMBURGUT PËR  
PROJEKTIN E BASHKËPUNIMIT PËR ZHVILLIM: “KSV/018:  
MBËSHTETJE INSTITUCIONALE DHE TEKNIKE PËR SISTEMIN E  
FURNIZIMIT ME UJË NË RAJONIN E MITROVICËS”**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim ratifikimin e Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me ujë në Rajonin e Mitrovicës”.

**Neni 2**  
**Ratifikimi i Marrëveshjes**

Ratifikohet Marrëveshja Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me ujë në Rajonin e Mitrovicës”, e lidhur më 7 Prill 2015, në Prishtinë.

**Neni 3**  
**Dokumentet e bashkëngjitura**

Bashkëngjitur në këtë ligj është Marrëveshja Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me ujë në Rajonin e Mitrovicës”.

**Neni 4**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L -056**  
**30 nëntor 2015**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Kadri VESELI**